

*Procesverbali i zbardhur i seancë së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2023*

**19.05.2023  
Ora 13:46**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendimi “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 62, subjekti ankues, Partia Uniteti Kombëtar”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, E. Mema.
- **Parti Politike:** PUK (Argjontjano Noka, Grejida Muça)
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. E. Çefa:** Mirëdita atëherë, riçelim seancën përgatitore për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 62, të paraqitur nga Partia e Unitetit Kombëtar kundër vendimit të KZAZ-së numër 12 dhe 13, përkatësisht vendimi numër 125, datë 17.05.2023 dhe vendimi numër 108 përsëri i së njëjtës datë, 17.05.2023. Verifikojmë pjesëmarrjen, është prezent trupa e KAS-it e përbërë nga 4 anëtarë, ç’ka nuk përbën në këtë fazë asnjë pengesë ligjore për të vijuar normalisht seancën, është prezent Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e tij, është prezent gjithashtu edhe përfaqësuesi, ankimuesit. Ju lutem prezantohuni fillimisht.

**Z. A. Noka:** Argjontjano Noka, përfaqësues i Partisë Unitetit Kombëtar.

**Znj. G. Muça:** Grejida Muça, përfaqësuese me autorizim.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2023*

**Z. E. Çefa:** Ju lutem e administron stafi autorizimin, përpara se të fillojmë. Ju, u prezantuat me trupën e KAS-it. Keni ndonjë kërkesë paraprake lidhur me përshtatshmërinë tonë për ta gjykuar këtë çështje? Për ndonjë konflikt interesi?

**Znj. G. Muça:** Jo, jemi dakord nuk kemi kundërshtime.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit, atëherë në këtë pikë mund të vazhdojmë, besoj jeni vënë në djeni me vendimin e djeshëm të ndërmjetëm të KAS-it, në marrjen e seancës paraprake për plotësimin e disa të metave të ankimit. A mund të na relatori shkurtimisht? I keni plotësuar këto të meta dhe çfarë keni administruar si prova, shtesë të ankimit tuaj?

**Z. A. Noka:** Përshëndetje! Kemi patur mbi 10 vëzhgues që dhe ato i kemi paraqitur në materiale, kemi patur mbi 10 vëzhgues që kanë mbajtur çdo numërim çdo votë dhe çdo lëvizje që është bërë atë ditë, brenda. Kemi konstatuar shumë shkelje realisht, por në një moment që ne i kapim dhe nga sistemi i janë hequr Partisë Socialiste 40 vota ku 16 nga këto janë shtuar Partisë numër 34, pasi ne konstatuam probleme dhe e ngritëm si problem, gjithçka shkoi në vendin e vet realish, në atë moment. Nga 3014 vota që kishte partia numër 34, i ra me 2998 pasi ne e konstatuam.

**Z. E. Çefa:** Pa dashur të të ndërpres, në këtë fazë ne nuk i kemi hyrë akoma gjykimit në themel të çështjeve, këto janë problematika që i përkasin themelit të çështjes, ne jemi në fazën paraprake. Pra jemi në fazën ku ju kërkua me vendim të ndërmjetëm

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2023*

që plotësoni ankimimin dhe të paraqisni dy vendimet e KZAZ-ve që ankimoni dhe provat, materialet shkresore, apo jo vetëm që ju i konsideroni të nevojshme për të shqyrtuar kërkesën. Në këtë fazë ne do të marrim vendim nëse do të vazhdojmë, do ta shqyrtojmë do të kalojmë në seancë, aty pastaj do të keni mundësinë deri në detaje për të dhënë shpjegime apo do ta mbyllim këtu. Kështu që pyetja ime ishte: I plotësuat kërkesën dhe provat bashkëlidhur që ne kërkuam nga seanca e djeshme? Cilat janë këto?

**Znj. G. Muça:** Po kemi dorëzuar vendimin numër 125 të KZAZ-së me numër 12, së bashku me tabelat përmbledhëse, kemi dorëzuar dy listat e vëzhguesve në cilësinë e provës, kemi dorëzuar dhe tabelat përmbledhëse të KZAZ-së numër 13, po nuk kemi vendimin që kundërshton, vendimin numër 108, sepse nga ana e KZAZ-së, e kryetarit të KZAZ-së na është vënë në dispozicion vendimi numër 107, që është për miratimin e listave për kryetar bashkie, edhe nuk e disponojmë dhe provat që i kemi dorëzuar janë foto të printuara, që janë vënë në dispozicion nga kryetarët e KZAZ-ve, sepse ishte koha shumë e shkurtër dhe nuk patëm mundësi t'i merrnim fizikisht.

**Z. E. Çefa:** Tani një pyetje tjetër kam unë. Lezha ka dy KZAZ apo jo? Ju besoj jeni në djeni të parashikimeve të Kodit Zgjedhor, që rezultati përfundimtar i Zonës së Administrimit Zgjedhor, që është Bashkia Lezhë do të miratohet nga KQZ-ja në këtë rast sepse përbëhet nga dy KZAZ dhe tabelat përmbledhëse të të dyja KZAZ-ve do të miratohen nga KQZ-ja dhe ajo do të konsiderohet si dokumenti përfundimtar, i rezultatit përfundimtar zgjedhor, të zgjedhjeve në atë zonë. Në këtë kuptim edhe afati juaj edhe e drejta juaj për të ushtruar ankim pastaj, ndaj këtyre tabelave përmbledhëse fillon nga momenti i miratimit nga Komisioneri Shtetëror i

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2023*

Zdhjedhjeve të këtyre tabelave dhe vijon për 5 ditë, që do të thotë, ne se dimë ju e keni bërë ankimin por e keni bërë praktikisht para kohe, edhe ne tani nuk mund të vijojmë më me shqyrtimin e këtij ankimi sepse me të vërtetë nuk ankimohet akti, i cili krijon pasoja të kundraligjëshme sipas jush i cili do të jetë eventualisht vendimi i Komisionerit, kështu që ne nuk mund ta vazhdojmë më këtë kërkesë ankimore, sigurisht duke ju sqaruar që ju nuk keni humbur asnjë të drejtë në këtë proces, thjeshtë koha në të cilën ju do të paraqisni të njëjtin ankim, por tashmë kundër vendimit të Komisionerit do të shtyhet në vartësi të marrjes së këtij vendimi nga Komisioneri. Jemi të qartë ne këtë pikë?

**Znj. G. Muça:** Po, të qartë.

**Z. A. Noka:** Po, ne do të bëjmë një ankim tjetër por realisht doja të shtoja dhe diçka sepse KZAZ-ja numër 12 i ka paraqitur të gjitha dokumentat përkatëse kurse KZAZ-ja numër 13 ku aty supozohet të ketë shkelje të mëdha realisht, ata nuk kanë paraqitur asnjë gjë dhe kjo më bën të dyshoj më tepër në ato që...

**Z. E. Çefa:** Ky fakt nuk ju privon ju nga e drejta që t'i bëni Komisionerit gjatë fazës që ai do të bëjë miratimin e tabelave përmbledhëse, tja parashtroni me shkrim Komisionerit këto që ai t'i ketë në konsideratë këto fakte, në momentin e miratimit dhe eventualisht i parashtroni dhe në ankimin e mundshëm që mund të bëni më vonë, në momentin e duhur përpara KAS-it.

**Z. A. Noka:** Dakord!

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2023*

**Z. E. Çefa:** Jemi dakord atëherë zoti Sekretar i Përgjithshëm?

**Z. Y. Merkaç:** Po.

**Z. E. Çefa:** Ndonjë pretendim?

**Z. Y. Merkaç:** Jo, brenda afatit të përcaktuar nuk i ka plotësuar.

**Z. E. Çefa:** Po jua thashë, nga vendimi i Komisionerit keni 5 ditë afat për të bërë ankim.

**Z. A. Noka:** Si mund të njoftohemi ne në këtë, kur të marrin vendim? Që mos të na ikin afatet.

**Z. E. Çefa:** Seancat e Komisionerit janë publike, duhet t'i ndiqni, krijoni një kontakt me administratën në mënyrë që t'ju njoftojnë.

**Z. Y. Merkaç:** Si rregull me fillimin e procesit, të materialeve të vetë Presidentit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i fton të gjitha partitë të caktojnë përfaqësues të përhershëm në KQZ deri sa të mbarojnë zgjedhjet dhe Partia e Legalitetit duhet të ketë përfaqësues. Përfaqësuesi presupozohet që është këtu në mbledhje ç' do ditë dhe merr njoftim për çdo zhvillim të seancave.

**Z. E. Çefa:** Dakord atëherë, KAS i konsultuar në vend, vendosi:

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2023*

- Pushimin e vendimit administrativ të kësaj kërkesë ankimore, pikërisht për arsye që u thanë pak më sipër.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Faleminderit, seanca deklarohet e mbyllur.

**Vendimi nr. 118**

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*

